

Mekanizmat dhe procedurat e ndjekura nga ana e Bashkisë Vlorë për t'u mundësuar qytetarëve që të japin mendimet e tyre apo të ndikojnë në hartimin e politikave publike apo të ushtrimit të funksioneve të autoritetit publik.

Në zbatim dhe të ligjit Nr. 146/2014, "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", Bashkia Vlorë ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për publikimin e njoftimeve për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projekt akteve. Bashkia Vlore ka dhënë informacion të vazhdueshëm në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projektaktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar. Për të gjitha nismat që janë ndërmarrë apo projekte, Bashkia ka organizuar konsultime të drejtpërdrejta dhe takime publike me palët e interesuara, per Planin e Pergjithshem Vendor , ndërsa Buxheti i është nënshtruar konsultimeve publike në çdo njësi ku qytetarët kanë shprehur mendimet e tyre.

Për njoftimin dhe marrjen e komenteve dhe rekomandimeve, Bashkia Vlorë ka përdorur një sërë mekanizmesh si a) posta elektronike; b) lajmërimi publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik inicues; c) lajmërimet në mediat audiovizive rajonale ose lokale; ç) botimet në gazeta lokale

Gjithashtu Bashkia Vlore i ka dhënë rëndësi dhe përdorimit të rrjeteve sociale për rritjen e transparencës dhe të informimit të qytetarëve. Disa mekanizma të tjera përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimin e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve janë si më poshtë:

- Spotelet e Drejtorisë së Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun
- Numri 033 421- 421
- Faqen zyrtare të Bashkisë Vlorë në Internet www.vlora.gov.al
- Adresën e-mail , informacioni@bashkiavlore.org
- Takime individuale
- Dëgjesat publike
- Takimet në terren me komunitetin
- Grupet e këshillimit
- Komisione qytetare